

Diaspora diskuton rolin e ardhshëm në Kosovë

■ NË KËTË NUMËR

Prezentimi i donatorëve:
Vëllezrit Rockefeller **2**

Rekomandimet nga kon-
ferenca **2**

Kërkohet Përfshirja më
e madhe e Diasporës **2**

Gabriel Sheffer,
Specialist për diasporë **3**

Grupi Punues për
Kodin e Sjelljes **3**

Rregullorja e re mbi
Shpëlarjen e Parave
afekton OJQ-të **3**

Konferenca mbi
avokuesit e FOI-së **4**

Formohet Grupi i ri për
Politika të Pavarura! **4**

■ NGJARJET E ARDHSHEME

Afati i dorëzimit të gran-
teve të FDI-së ...**7 qershor**

Trajnim: "Shkrimi i
Projektpropozimeve" me
Institutin Kombëtar
Demokratik (NDI)
.....**28-29 qershor**

29 maj. Prishtinë.

Për herë të parë në Kosovë u mbajt konferenca mbi rolin e diasporës në zhvillimin demokratik për të diskutuar marrëdhëniet e ardhshme diasporë-atdhe. Pjesëmarrësit e konferencës diskutuan mungesën e organizimit lidhur me përfshirjen e diasporës në

Kosovë dhe kërkuan themelimin e një sistemi më të strukturuar të financimit, përmes të cilit diaspora, shoqëria civile dhe qeveria mund të punojnë drejt zhvillimit të Kosovës.

Konferenca ishte pjesë e Projektit të OJQ-ve Kosovare në Avokim (KNAP), një marrëveshje bashkëpunimi mes Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim, Inc. (EWMi) dhe USAID-it dhe e zbatuar nga dy

partnerë vendorë të EWMi-t, Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI) dhe Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve në Avokim (ATRC). Synimi i konferencës ishte trepalësh: i) të diskutojë strategjitë e komunitetit të diasporës në tërë botën lidhur me ndihmën për vendlindjet e tyre; ii) të diskutohen programet

dhe përnxitjet për bashkëpunim më të madh mes organizatave kosovare dhe komuniteteve në diasporë, dhe iii) të mësohen mësimet nga rajoni - shembuj të programeve që ndërlihin komunitetet në diasporë me vendlindjet e tyre.

Rreth 100 përfaqësues

punuar me programe që ofrojnë përnxitje për angazhim më të madh të diasporës në Kosovë; OJQ-të kosovare dhe disa qytetarë morën pjesë në konferencë.

Konferenca i lejoji pjesëmarrësit që të identifikojnë dhe caktojnë çështjet dhe programet me përparësi të cilat do të shpien në rritjen e



Paneli përmblyllës, me Gabriel Sheffer, Doktor i Shkencave, David Moore (ICNL), Howie Katz, (AJWS) Delina Fico (Star Network), Martin Vulaj (NAAC), Bashkim Rrahmani (FDI) dhe Argjentina Grazhdani (USAID), diskutoi rekomandimet e ardhshme.

"Veprimtaritë dhe vendimet e diasporës mund t'i japin Kosovës dhe popullit të vet një të ardhme më të ndritshme. Pasiviteti i diasporës do t'i kontribuojë dëshpërimit dhe pashpresës," tha Marcie Ries, Shefe e Misionit të Zyrës Amerikane në Prishtinë gjatë fjalimit të hapjes në konferencë.



nga Shtetet e Bashkuara, Izraeli dhe Evropa Qendrore dhe Lindore me përvojë të konsiderueshme në punë me komunitetet e diasporës, OJQ-të kosovare dhe shoqatat; ekspertët kosovarë (p.sh, profesorët e universitetit), të cilët kanë punuar me komunitetin në diasporë; përfaqësues të qeverisë Kosovare, e cila është momentalisht duke

bashkëpunimit mes organizatave kosovare dhe komuniteteve në diasporë që do të kontribuojë direkt në zhvillimin e tërësishëm të Kosovës, përfshirë ekonominë, arsimin dhe qeverisjen e mirë.

"Arsyeja kryesore që komunitetet në diasporë hezitojnë të mbështesin projekte më të qëndrueshme në aspektin politik, ekonomik dhe diplomatik të zhvillimit të qeverisë në nivelin institucional, përmes së cilës mund të themelohet një proces transparent duke rritur kështu kompetencën dhe realizueshmërinë e projekteve si dhe pjesëmarrjen," tha Martin Vulaj, drejtor i përgjithshëm i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-

Rekomandimet e konferencës

Për Qeverinë e raport me diasporën

- Të përmirësojë komunikimin
- Të mbështesë transparençën
- Të krijojë një nivel personal i komunikimit në të institucionet
- Të ndërtojë marrëdhënime dhe jep (qeveria dhe të cilëve politika korrekte); dhe
- Të tregojë rezultatet

Çaerim të tërësishëm shoqëria civile për diasporën

- Të përmirësojë komunikimin (interet);
- Të tregojë përgjegjësinë dhe transparençën
- Të krijojë politika të sigurt fiskale brenda OJQ-ve
- Të caktojë përfaqësues që ofrojnë përnxitje për diasporë dhe investime nga diaspora dhe
- Të tregojë rezultatet

Fondi i Vëllezërve Rockefeller

10 Maj - Fondi i Vëllezërve Rockefeller me përfaqësuesin e vet Grant Garrison pati një takim me OJQ-të Kosovare në ATRC.

Fondi ndjek interesat e katër programeve të veta - praktikat demokratike, zhvillimi i qëndrueshëm, paqja dhe siguria dhe avancimi njerëzor - në shumë kontekste gjeografike. Përveç kësaj, Fondi ka identifikuar disa vendndodhje specifike ku do ta përqëndrojë vëmendjen e mbledhjes së granteve ndër-programore.

Fondi i Vëllezërve Rockefeller ka qenë i angazhuar në mbledhjen e fondeve në Ballkan sidomos në Serbi dhe Mali të Zi që nga pranvera e vitit 2001, ku këshilli i vet administrativ e identifikoi rajonin si "bregë e veçantë" e Fondit. Puna e Fondit këtu përfshin më shumë se 20 vjet përvojë me grante në Evropën Qëndrore dhe Lindore e cila do të përfundohet në vitin 2003.

Fondi aktualisht po planifikon zgjerimin e projekteve të veta në Kosovë, sidomos në fushën e politikave publike dhe demokracisë së qëndrueshme. Një nga nëndonatorët e mundshëm në rajon është edhe Fondacioni për Iniciativa Demokratike në Gjakovë, i cili në të ardhmen mund të shpërndajë fonde për Fondin e Vëllezërve Rockefeller. Fondi synon të:

- mbështesë kapacitetet dhe kryerjen e punëve të institucioneve qeveritare.
- promovojë një mirëkuptim të thellë të rolit të organizatave joqeveritare në shoqërinë demokratike.
- krijojë kushte për marrëdhëniet efektive mes qeverisë dhe institucioneve të shoqërisë civile. Për më shumë informata rreth Fondit Rockefeller vizitoni faqen e tyre të internetit:

www.rbf.org

Konferenca: Komunitetet e diasporës në zhvillim

Amerikan (NAAC). "Mes të tjerash është i nevojshëm edhe themelimi i mekanizmeve të komunikimit, ku nevojat dhe mundësitë komunikohen, sigurisht konferencat sikur kjo, të cilat ofrojnë shkëmbimin e ideve mes sektorit të OJQ-ve kosovare dhe atyre nga ShBA-ja", shtoi ai.

David Moore nga Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jofitimprurës (ICNL) ofroi shembuj të përnxitjeve fiskale në nivelin vendor dhe ndërkombëtar, të cilat do t'i inkurajonin donatorët. Ai, poashtu, sugjeroi që OJQ-të Kosovare dhe përfaqësuesit e qeverisë të punojnë në edukimin e donatorëve individualë në diasporë lidhur me përfitimet

Kreshnik Berisha (Drejtor i ATRC-së), Bashkim Rrahmani (Drejtor i Përgjithshëm i FDI-së), Fron Nazi (Shef i misionit për EWWI/KNAP), dhe Natyra Zheqji (Përgjegjëse për Trajtime në ATRC) (nga e majta në të djathtë) ofruan rekomandime.



që ata mund t'i marrin nga dhënia e donacioneve (si korporatë apo individë). Kosovarët duhet ta ngrejë vetëdijen e diasporës lidhur me projektet e tjera të diasporës si dhe iniciativat kosovare, tha ai.

Igballë Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e Rrjetit të Grave Kosovare prezantoi një shembull të qytetarëve dhe OJQ-ve të bazuara në

rajonin specifik.

Zef Shala nga organizata humanitare Nënë Tereza dhe Kristin Griffith nga Mercy Corps ofruan shembuj të përfshirjes së diasporës, kryesisht të orientuara kah ndihma humanitare në Kosovë. Lufti Haziri, Kryetar i Komunitetit të Gjilanit dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit folën rreth veprimtarive të qeverisë kosovare në raport me komunitetin e diasporës deri më tani.

Howie Katz nga Shërbimi Botëror Hebreo-Amerikan rekomandoi për OJQ-të që kërkojnë përfshirjen e diasporës, se në të ardhmen duhet t'i përmbahen misionit të tyre; të koordinohen me donatorë dhe t'i përfshijnë femrat, të cilat zakonisht japin më shumë fonde direkte për ta përmirësuar situatën. ■



Pjesëmarrësit e konferencës bën pyetje për folësit.

Kërkohet përfshirja më e madhe e diasporës në Kosovë

Në dhjetëvjeçarin e kaluar, komunitetet në diasporë janë bërë burime të rëndësishme të financimit dhe burimeve njerëzore në fushën e zhvillimit ndërkombëtar. Si "vendas" që jetojnë jashtë vendit, antarët e komunitetit në diasporë ishin të aftë të tejkalojnë komunitetin ndërkombëtar dhe të vendosin kontakt direkt me organizatat vendore. Si pasojë, kontributet e diasporës shpesh janë të paidentifikuara për shumicën e organizatave ndërkombëtare. Sipas studimeve të Kombeve të Bashkuara mbi rolin e komunitetit të diasporës në zhvillimin ndërkombëtar, shumica e njerëzve do të pajtoheshin se si komunitetet e diasporës ashtu

edhe donatorët ndërkombëtarë kanë dështuar të shfrytëzojnë plotësisht burimet e njëri-tjetrit në mënyrë që të ofrohet përkrahja më e mirë e mundshme për popullsinë vendase.

Ka patur shembuj të suksesshëm të organizatave për ndihmë ndërkombëtare që kanë koordinuar përpjekjet e tyre me komunitetet e diasporës. Në Kosovë shumica e programeve të tilla të përbashkëta të suksesshme kanë qenë humanitare.

Edhe pse varfëria në Kosovë mbetet ende një dukuri, organizatat për zhvillim ndërkombëtar dhe komuniteti në diasporë duhet të përfitojnë nga përparësitë e njëri-tjetrit dhe të

punojnë së bashku për të zhvilluar programe të cilat mbështesin organizata joqeveritare proaktive të orientuara kah çështjet si dhe kapacitetet e vendorëve për të adresuar zhvillimin ekonomik, arsimin, kulturën dhe qeverisjen e mirë. Siç është pritur, pas pesë vjetësh ndihma ndërkombëtare është duke rënë me shpejtësi derisa në të njëjtën kohë kapaciteti dhe efikasiteti i organizatave vendore po rritet. Por me shpërnguljen e komunitetit tradicional të donatorëve ndërkombëtarë, duhet të futet brenda diaspora kosovare në mënyrë që OJQ-të Kosovare dhe programet e ndryshme të mos zhduken. ■

Grupi punues diskuton Kodin e Sjelljes

18 maj - Grupi punues i sapo themeluar për Kodin e Sjelljes u takua në ATRC për të diskutuar rëndësinë e hartimit të Kodit të Sjelljes për shoqërinë civile si dhe një stuhi mendimesh për aktivitetet e ardhshme. Për takimin e ardhshëm Grupi punues u pajtua të shqyrtoj materialet për Kodin e Sjelljes që do ti propozoj Instituti Kosovar për të Drejtën e OJQ-ve (IKDO).

Grupi punues, i themeluar muajin e kaluar pas diskutimit publik në ATRC, përbëhet nga Kreshnik Berisha - ATRC, Gjyljeta Mushkolaj - IKDO, Igballe Rogova - Rrjeti i Grave të Kosovës, Veton Mujaj - Syri i Vizionit dhe Teuta Luzha - Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI).

Pasi të jenë shqyrtuar propozimet për kodin e sjelljes, anëtarët e grupit punues do të kërkojnë rekomandime nga OJQ-të e tjera përmes një pyetësori, i cili do t'i shpërndahet të gjitha OJQ-ve të cilat dëshirojnë që të ndjekin Kodin e Sjelljes. Grupi punues propozoi dy versione të pyetësorit: njëri me standarde më të ashpra dhe tjetri me më të buta.

"Hartimi i Kodit të Sjelljes është një proces. Duhet një kohë e gjatë për të shkruar një kod të cilit do t'i përmbahesh," tha Mushkolaj.

Kodi i sjelljes është i ngjashëm me statutin dhe inkorporon politika të konfliktit të interesit të përcaktuara qartë të cilave duhet t'i përmbahen antarët, sqaroi ajo.

Mushkolaj theksoi se Kodi i Sjelljes është rregullore që nuk nxirret nga qeveria: Ombrella e OJQ-ve i përmbahet standardeve të caktuara dhe vetërregullohet për të fituar besimin nga institucionet qeveritare dhe populli.

Grupi punues do të takohet çdo muaj që të diskutojë shembujt e kodeve të sjelljes dhe të shkruajë një Kod të Sjelljes të zbatueshëm për rrethanat e Kosovës. Nëse dëshironi më tepër informata apo doni të inkuadroheni kontakti ATRC-në. ■

Gabriel Sheffer, specialist mbi diasporën flet nga përvoja

29 maj - Gabriel Sheffer (Doktor i Shkencave), profesor i shkencave politike në Universitetin Hebrej në Jerusalem, foli për marrëdhëniet diasporë-atdhe (vendi i prejardhjes) në konferencën mbi diasporën. Ai bëri dallimin mes marrëdhënieve të diasporës pa shtet dhe asaj të lidhur me shtetin dhe atdheun e tyre. Mes të tjerash, Sheffer-i argumentoi se tensionet mes diasporës dhe popullit në atdheun e tyre janë krijuar për shkak të llojeve të ndryshme të mundshme të përkrahjes

Shtatë këshillat e Sheffer-it

Për punën me komunitetet në diasporë:

- 1** Lejohet autonomia e diasporës
- 2** Shkëmbimi i informatave
- 3** Të tregohet interesim dhe përkrahje për diasporën
- 4** Të investohet në internet
- 5** Tregoni vëzhgimet; paraqitni realitetin
- 6** Inkurajohen donacionet e veçanta; të jesh i përgjegjshëm dhe transparent
- 7** Investoni në marrëdhëniet e rinisë me atdheun e tyre

(politike, diplomatike dhe ekonomike), që diasporat dëshirojnë dhe mund ta zgjerojnë në atdheun e tyre.

Sheffer-i beson se, pasi që komunitetet në diasporë po rriten në numër për shkak të emigrimit, ato do të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në atdheun e tyre, vendin ku banojnë dhe ndërkombëtarisht përsa i përket politikës, ekonomisë, etj.

"Idea për pikën shkrirëse ka vdekur," tha Sheffer-i duke përshkruar tendencat e shumë komuniteteve të emigrantëve për të mbajtur kulturën e tyre tradicionale në vend që të asimilohen. Ai sugjeroi që të bëhet më shumë për përmirësimin e komunikimit mes anëtarëve të diasporës, vendit ku banojnë dhe atdheut të tyre, sidomos përmes mjeteve kulturore siç janë letërsia dhe filmi.

Derisa interesi i Sheffer-it filloi me rolin e diasporës he-



breje në politikën e jashtme të Izraelit, që nga atëherë ai ka zgjeruar hulumtimin e tij duke përfshirë komunitetet e diasporës nëpër tërë botën. Ai njihet si shkollar kryesor mbi diasporat dhe ka botuar një sërë artikujsh dhe librash mbi këtë çështje. Libri më i fundit është Politika e diasporës: Në atdhe dhe jashtë tij, i cili është me siguri libri i parë që është fokusuar në aspektet politike të këtyre çështjeve. Një vëllim i botuar më herët: Diasporat moderne në politikën ndërkombëtare, është konsideruar gjerësisht si vëllimi i parë sistematik që trajton fenomenin e diasporës. ■

OJQ-të duhet t'i përmbahen Rregullores së Re për Shpëlarjen e Parave

19 maj - Edhe pas themelimit të kuvendit të Kosovës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) vazhdon të nxjerrë rregullore pa pjesëmarrjen e publikut. Shembulli më i fundit është edhe rregullorja e UNMIK-ut mbi shpëlarjen e parave, e aprovuar në shkurt dhe e nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e cila do të hyjë në fuqi në korrik. Karakteristik është fakti se aprovimi i rregullores që ndikon në shkallë të madhe në shoqërinë tonë, nuk tërhoqi vëmendjen e mediave përveç disa raporteve të shkurta në gazetën ditore. "Rregullorja paraqet një pengesë të madhe për korupsionin dhe krimin e organizuar. Ajo themelon mekanizma për zbatimin efektiv të sundimit të ligjit," tha Gjyljeta Mushkolaj, eksperte ligjore nga Instituti Kosovar për të Drejtat e OJQ-ve (IKDO). Sipas rregullores këto de-

tyrime do të përmirësojnë poashtu shëndetin financiar të Kosovës, tha ajo. "Synimi i kësaj rregulloreje është që të parandalojë praktikat korruptuese që i deprimojnë fondet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës," tha Naser Gjinoçci, avokat i pavarur. Për të rritur vetëdijësimin publik rreth rregullores së re, ATRC-ja mbajti diskutimin të cilën e ndoqën 20 OJQ dhe u mbulua gjerësisht nga mediat. Diskutimi u përqëndrua në detyrimet financiare të OJQ-ve të parapara me këtë rregullore: - Përderisa një OJQ nuk kalon nëpër procedurat relevante institucionale, OJQ-të nuk mund të marrin donacione mbi 1,000€ nga i njëjti burim të njëjtën ditë.

- OJQ-ja nuk mund të shpenzojë më tepër se 5,000€ nga buxheti i saj të njëjtën ditë.

- Nëse një OJQ pranon më tepër se 10,000€ në vit, duhet që të sigurojë informata mbi burimin dhe arsyetimin për



Mediat e intervistojnë drejtorin Kreshnik Berisha rreth rregullores së re mbi shpëlarjen e parave.

marrjen e fondeve.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Qendra për Informim Financiar brenda Shtyllës së Parë - Policia dhe Drejtësia. Kjo qendër mund të lëshojë leje, leje me kusht ose fare për transaksione financiare. Entitetet nuk kanë të drejtë për ankesë.

Prandaj, pavarësisht nëse kanë status të përfitimit publik apo jo ato duhet të mbajnë një listë të saktë të të hyrave dhe shpenzimeve. ■ lexo më shumë: www.unmikonline.org



Advocacy Training & Resource Center

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
(ish Ramiz Sadiku)
Kati i dytë
Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 38 244 810

Fax: +381 38 244 810

Email: atrcknap@yahoo.com

Drejtor
KRESHNIK BERISHA
keka@advocacy-center.org

**Menaxhere e
Përgjithshme**
KIMETE KLENJA
kimete@advocacy-center.org

Menaxhere e Trajnimeve
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

**Përgjegjëse për
Informim dhe
Marrëdhënie me Publik**
NICOLE FARNSWORTH
nicole@advocacy-center.org

**Koordinatorë për
Informim dhe
Marrëdhënie me Publik**
DAFINA ZHERKA
dafina@advocacy-center.org

Administrator Zyre
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org

*Nëse keni pyetje apo
sugjerime lidhur me kon-
ferencën mbi diasporën
ose marrëdhëniet dias-
porë-Kosovë na i dërgoni
ato në dafina@advocacy-
center.org*

Avokatët e Lirisë së Informimit diskutojnë zbatimin dhe monitorimin e Ligjit për Qasje në Informim

14 maj - Përfaqësuesit e më shumë se 30 shteteve u mbledhën në Sofje, Bullgari për të shkëmbyer përvoja se si të avokohet për zbatimin e Ligjit për Qasje në Informata (FOIA) në vendet e tyre. Përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, organizatat joqeveritare nga vendet e Evropës Jug-Lindore dhe OJQ-të ndërkombëtare të përfshirë në projektin e FOIA-së diskutuan veprimtaritë e tyre aktuale dhe caqet e ardhshme.

ATRC-ja mori pjesë në konferencë dhe Kreshnik

Berisha, drejtori i ATRC-së pati një prezantim shumë kreativ në power point rreth procesit të aprovimit të FOIA-së në Kosovë, ku tregohet rruga naviguese nëpër strukturat komplekse qeverisëse të Kosovës.

Sipas raportit të fundit nga Programi për Qasje në Informata AIP në Bullgari, 50 shtete e kanë aprovuar legjislacionin për lirinë e informimit dhe 30 të tjera janë në përp-



Kreshnik Berisha, Drejtor i ATRC-së sqaroi procesin e aprovimit të ligjit FOI-së si "të komplikuar".

Rrjeti Avokues për Lirinë e Informimit (FOIA)

Rrjeti FOIA i themeluar më 28 shtator 2002 në Sofje përbëhet nga 334 antarë të cilët përfaqësojnë vendet si Evropa, Amerika Jugore, Azia, Afrika dhe Amerika Veriore. Veprimtaritë kryesore të FOIA-së janë:

- Promovimi dhe zhvillimi i standardeve ndërkombëtare mbi qasjen në informata, duke avokuar si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar për këtë të drejtë;
- Shkëmbimi i informatave rreth veprimtarive dhe përvojave; dhe
- Promovimi i ditës ndërkombëtare "E drejta për të ditur" më 28 shtator para organizmave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

Aktualisht, disa anëtarë evropianë të Rrjetit të FOIA-së, përfshirë ATRC-në, po e zbatojnë projektin për Ligjin mbi Lirinë e Informimit që financohet nga Article 19 në Britaninë e Madhe. Projekti synon të inkurajojë kërkesat individuale dhe publike për informata të mbajtura nga qeveria; të lehtësohet e drejta për qasje në informata publike dhe të punohet drejt transparencës.

FDI, ATRC dhe KODI i bashkojnë forcat

maj 2004 - Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI), Instituti Kosovar për Kërkime dhe Dokumentime (KODI) dhe ATRC i kanë bashkuar përpjekjet për të ndikuar në hartimin e politikave në Kosovë duke krijuar Grupin e Pavarur të Politikave (GPP). Kjo vjen pas tre vjet pune të sukseshme avokimi së bashku. Gjatë pesë vjetëve të fundit shumë veprime janë ndër-marrë nga OJQ të ndryshme, por ato dukshëm kanë patur ndikim të kufizuar mbi proceset e vendim-marrjes. Në të njëjtën kohë, derisa grupet ndërkombëtare të ekspertëve kanë hartuar dokumente të shkëlqyeshme të analizave publike, atyreve shpesh iu ka munguar per-

spektiva vendore. Brenda Grupit të Pavarur të Politikave, të trija organizatat kanë këto përgjegjësi:

- FDI-ja, një institucion i certifikuar lartë fiskalisht që jep grante dhe monitoron grante, do të jetë përgjegjës për mbledhjen e granteve dhe menaxhimin financiar të projekteve të GPP-së;
- KODI, një institut i njohur për analiza të politikave publike, do të hulumtojë dhe prodhojë dokumente politikash të cilat do të udhëqin veprimtaritë zbatuese të GPP-së; dhe
- ATRC-ja, e specializuar në avokim, informim dhe trajnime, do të bëjë monitorimin dhe lobimin në nivelin e hartimit të politikave duke aprovuar rekomandime.

Këtë vit GPP-ja do t'i drej-

jekje e sipër. Në konferencë pjesëmarrësit e theksuan nevojën për të shkruar përtej ratifikimit në zbatim. "Edhe pse ligji cilësor është i domosdoshëm, ai nuk ka ndonjë forcë magjike derisa nuk monitorohet," theksoi Ioana Avadani nga Qendra për Gazetari të Pavarur në Rumani.

"Monitorimi nuk është vetëm prodhimi i dëshmive të moszbatimit të ligjit me të cilën bëhet presion në qeveri, por është poashtu edhe një mjet i rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes publike," shtoi Sarah Buchanan nga Article 19. ■

tojë aktivitetet e saj në dy fusha kryesore:

1. Axhenda për institucionet e reja të Kosovës

GPP-ja do të hartojë një axhendë katërvjeçare, pavarësisht nga partitë politike, por në bashkëpunim me ato dhe institucione tjera. Axhenda do të hartohet gjatë gjashtë muajve të ardhshëm dhe do t'i paraqitet qeverisë së re dhe publikut në nëntor 2004.

2. Pasqyra e pakicave

GPP-ja do t'i bashkojë veprimet për të prodhuar profile për pakicat kosovare. Profilet do të përfshijnë informata nga historia e pakicave, gjendja e tyre aktuale si dhe rekomandimet se si ata mund të integrohen më së miri në shoqërinë kosovare. ■